



REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK	Nr. Prot.	03-02/4820/16
Dep.		B. ot.	
Dep.		Pr. No.	
Nr. l. i. t. u.		Dit. i.	20.12.2016
Broj. strana	02	Ditun.	
Nr. page		Dat.	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.12.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-2975/16, për z. Ejup Kastrati – Menaxher i Prokurimit Komunën e Dardanës (Kamenicës), për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-2975/16, për z. Ejup Kastrati – Menaxher i Prokurimit Komunën e Dardanës (Kamenicës), është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Kastrati, është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik të Menaxherit të Prokurimit dhe personit të autorizuar në biznesin privat K.N.P.T. “Ing-Muratori” Sh.p.k.

Ai fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, z. Kastrati është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t’i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Kastrati, është bindur për kufizimin e funksionit menaxherial në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për t’i bërë ndryshimet e nevojshme.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë me të cilën vërtetohet se ai ka emëruar një “person të besueshëm”, në funksionin e personit të autorizuar, ashtu siç parashihet me Ligjin PKI. Me këtë ai ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Shaip Havolli

